



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 26 janar, gjykatësi i çështjes lëshoi një vendim në lidhje me një dëshmitar që Prokuroria planifikon ta thërrasë në gjykim. Gjykatësi vendosi të shtyjë marrjen e vendimit nëse ky dëshmitar konsiderohet ekspert dhe nëse raporti dhe materialet shoqëruese të dëshmitarit mund të pranohen si prova pasi dëshmitari të ketë dhënë dëshmi, siç u kërkuar nga Mbrojtja. Mbrojtja kishte njoftuar më parë se do të kundërshtonte dëshmitarin si ekspert, si edhe pranimin e raportit. Kjo procedurë ndjek rregullën 149 të Procedurës dhe të Provave lidhur me dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë.

Në të njëjtën çështje, më 27 janar, Gjykatësi i Vetëm i çështjes miratoi një kërkesë të Prokurorisë për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për një parashtrim mbi pranimin e provave, pasi i kishte miratuar Mbrojtjes shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për një parashtrim të ndërlidhur një javë më parë.

Më 28 janar, Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për shtyrjen e fillimit të gjyimit që më parë ishte planifikuar për më 24 shkurt dhe caktoi 27 shkurtin 2026 si datë të re për fillimin e tij. Gjykatësi i çështjes gjykoj se kanë ndryshuar dy faktorë të rëndësishëm për fillimin e gjyimit: caktimi në mënyrë përfundimtare i dy ditëve shtesë për deklaratat përmbyllëse në çështjen për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, më 16 dhe 18 shkurt; dhe qartësia më e madhe për kohën që do të nevojitet për marrjen në pyetje të dëshmitarëve të ZPS-së.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kujtojmë se deklaratat përmbyllëse janë planifikuar të mbahen nga 9 deri më 13 shkurt, dhe më 16 dhe 18 shkurt. Seancat janë planifikuar të fillojnë në orën 09:00 dhe të mbarojnë në orën 16:30, dhe mund të ndiqen përmes internetit në tri gjuhët e gjykatës, shqipe, anglishte dhe serbishte përmes [transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së](#), me 45 minuta vonesë, ose nga galeria publike ndërtesën e gjykatës në Hagë. Rendi i ditës për deklaratat përmbyllëse është bazuar në vlerësimet e deritanishme dhe mund të ndryshojë, për shembull në qoftë se një palë merr më pak kohë se është parashikuar.

Për shkak të interesit të madh për përcjelljen e seancave gjatë këtyre ditëve, regjistrimi paraprak është i domosdoshëm për t'i ndjekur seancat nga galeria për publikun në ndërtesën e gjykatës në Hagë. Afati i fundit për regjistrim paraprak është nesër, 30 janar.





Versionet e redaktuara të parashtrimeve dhe vendimeve në lidhje me kërkesën e Salih Mustafës për lirim të përkohshëm të dorëzuar në dhjetor të vitit të kaluar, janë tani në dispozicion në faqen e internetit të DHSK-së.

Sikurse pasqyrohet në parashtrime, Gjykatësi i Vetëm mori në shqyrtim, të hënën më 22 dhjetor, kërkesën e z. Mustafa për të vizituar babain e tij në spital dhe po atë ditë ai lëshoi një vendim me të cilin u kërkoi palëve dhe Zyrës Administrative të dorëzonin parashtrime të mëtejshme. Të nesërmen, Mbrojtja dorëzoi një parashtrim shtesë, si edhe dokumentacion mjekësor të përditësuar. Në kohën kur babai i Salih Mustafës ndërroi jetë, më 25 dhjetor, Gjykatësi i Vetëm ende nuk kishte përfunduar shqyrtimin e parashtrimeve të mëtejshme.

Më pas, Gjykatësi i Vetëm ftoi Mbrojtjen të bënte të ditur nëse dëshironte të ndryshonte kërkesën e parë, ndër të tjera, për të vizituar varrin ose anëtarët e familjes. Mbrojtja e informoi gjykatën se nuk do të dorëzonte ndonjë kërkesë të mëtejshme ose të ndryshuar dhe, rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm deklaroi kërkesën të tejkaluar. Më shumë hollësi lidhur me parashtrimet mund të gjeni në faqen e internetit.

Në lidhje me programin për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së, dëshirojmë të përsërisim informacionin e dhënë javën e kaluar se qëllimi i aktiviteteve të përcjelljes së informacionit është që të ofrojnë informacion bazë për mandatin dhe veprimtarinë e Gjykatës, t'u japin njerëzve në Kosovë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre dhe, mbi të gjitha, t'u përgjigjen pyetjeve të tyre.

Informacioni që jepet gjatë këtyre aktiviteteve është i njëjti informacion që mund të gjendet edhe në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara. Gjykata është një institucion i ndarë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i administruar nga Zyra Administrative si organ asnjans i Gjykatës, nuk përfaqëson as Prokurorinë, as Mbrojtjen. Prezumimi i pafajësisë së një të akuzuari komunikohet qartë. Në informacionin që përcillet nuk përfshihet përmbajtje politike apo ideologjike.

Gjykata raporton rregullisht në informimet javore me mediat, në faqen e internetit. DHSK-ja e vlerëson të rëndësishme të dëgjojë mendimet e njerëzve në Kosovë dhe t'u përgjigjet pyetjeve të tyre përmes Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim.

